

- a) për të kontribuar në përbushjen e objektivave të Qeverisë për politikat sociale të strehimit, si një nga priorititetet e saj;
- b) për të adresuar problemet e strehimit për shtresat të cilat nuk mund të përballojnë dot çmimet e banesave në tregun e lirë;
- c) për të realizuar ndërtimin e një banese me kosto të ulët dhe eficencë energjie;
- d) për të miratuar në parim, vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e strehimit, duke eksploruar bashkërisht forma e rrugë të tjera ligjore.

## **Neni 2**

### **Objekti dhe Kushtet e marrëveshjes**

1. Objekt i akt-marrëveshjes është financimi dhe ndërtimi gjatë viteve 2024-2028, i një objekti banimi me 8 kate dhe me një kat parkimi nëntokë.
2. Financimi i objektit do të realizohet nga të ardhurat e vetë Entit Kombëtar të Banesave.
3. Objekti i banimit klasifikohet në programin e banesave me kosto të ulët dhe do të shërbejë për strehimin e familjeve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Korçë, për të përfituar banesë me kosto të ulët.

## **Neni 3**

### **Angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve**

1. Palët e kësaj marrëveshje angazhohen:
  - Të bashkëpunojnë me vullnet të lirë dhe në mënyrë konstruktive në drejtim përbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
  - Në çdo rast, kur është e mundur, të publikojnë vlerat dhe kontributet e njëra-tjetrës në këtë projekt të përbashkët.
2. Enti Kombëtar i Banesave, si palë e kësaj marrëveshje, merr përsipër:
  - a) të realizojë financimin e plotë të një banese ku përfshihen: projektimi, ndërtimi, mbikqyrja, kolaudimi dhe regjistrimi i pasurisë në emër të Entit Kombëtar të Banesave;
  - b) të vendosë në dispozicion të Bashkisë Korçë të dhënat teknike-ekonomike të banesës (strukturat, sipërfaqet, çmimet e apartamenteve, etj), si dhe kritere të tjera paraprake që konsiderohen të domosdoshme nga EKB (psh. minimumin e të ardhurave që duhet të ketë familja përfituese etj.), në funksion të përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit të listave të familjeve përfituese nëpërmjet Këshillit Bashkiak.
3. Bashkia Korçë, si palë e kësaj marrëveshje merr përsipër:
  - a) Të realizojë prishjen e objektit ekzistues dhe pastrimin e sheshit që do të shërbejë për ndërtimin e objektit.
  - b) Të vërë në dispozicion të projektit: